

Senat Saliu, MA¹
Arijanit Racaj²

UDC:
355-061.2

**KOMPANITË PRIVATE USHTARAKE – FENOMEN NË SFEREN
E SIGURISË NË SHEKULLIN XXI**

**ВОЕНИТЕ ПРИВАТНИ КОМПАНИИ – ФЕНОМЕН ВО
СЕКТОРОТ ЗА БЕЗБЕДНОСТ ВО XXI ВЕК**

**PRIVATE MILITARY COMPANIES – A PHENOMENON OF
THE 21st CENTURY IN THE SECURITY SECTOR**

Abstract

Private Military Companies are a new phenomenon in the security sector. Their role in the contemporary conflicts are a result of the internationalization of the security sector after the end of the Cold War. According to David Eisenberg, of the American – British Security Council (BASIC), a few main circumstances are important, which helped the bringing up and the developing of the Private and Security Military Companies. First of all, the decrease of the military and security apparatus – intelligence after the Cold War left hundreds and thousands of professionals all over the world jobless. The end division of the block, ignited many ethnic conflicts all over the world. Neither USA, nor Russia could not solve them fast enough. Private Companies were those that filled the vacuum caused by helping one of the antagonist parties in the created judgments.

The pursuit that the main threat for the security of a country comes from the enemy states and other alliances is abundant almost

¹MA, Senat Saliu, Master of the Security Science, senat.saliu@fon.mk

² Arijanit Racaj, Magistrant, FON University –Skopje, e-mail: arianit.racaj@hotmail.com

completely. According to the modern notions and understandings, the main problems appear to be terrorism, organized crime, ethnic conflicts, the spread of the nuclear weapons, etc. This required military organizing, police and the security services – intelligence.

Terrorist attacks in New York and Washington on the 11th September 2001 and the American intervention in Afghanistan and Iraq, revealed the organizational weaknesses of all the defense apparatus that US had back then. So, again there was a need for additional personnel, same as for the other duties which the traditional military was accomplishing through the security structures – intelligence. While not being able to find a fast solution and with the lack of the qualified personnel, different states asked Private Military Companies for help.

Their services include counseling and training or a direct involvement in conflicts, also selling weapons regardless of the possible embargo, intelligence jobs – counterintelligence etc. These companies can be divided into Private Military Companies and Private Security Companies. Bigger private companies can operate both as Military and Security Organizations. The employees of these companies are mainly *ex soldiers*, officers or informers. The work in the company which provides services from the security sector is what distinguishes them from the usual mercenaries that work for them and pay them higher wages.

These companies are spread almost everywhere; from the conflict zones, to the states that reform their security sectors. The most interesting zones to work in are Iraq, Afghanistan and traditionally Africa.

Key words: Security, Intelligence, Threats, Services, Companies.

Hyrje

Pagesa padyshim është një prej zanateve më të vjetra dhe si e tillë edhe sot është ende lëndë e tregut të luftës, e cila ka klientët e saj dhe ofruesit e shërbimeve. Përveç formave tradicionale të pagesës dhe ofertat e forcave ushtarake private, sot kemi edhe forma të reja të angazhimit të kompanive private ushtarake dhe kompanive private të sigurisë, kapacitet që punon dhe vepron në kuadër të errët, përkatësisht me kornizë të paprecizuar dhe të parregulluar juridike dhe ligjore.

Industria private e sigurisë shfaqet kah fundi i viteve të nëntëdhjeta të shekullit XX si rezultat i tre faktorëve crucial: fundi i Luftës së Ftohtë dhe vakumi që ajo shkaktoi në kërkimin dhe ofrimin e

shërbimeve nga fusha e sigurisë, transformimin në natyrë të luftimit dhe rritjen normative të privatizimit në të gjithë sektorët, krijimin e hapësirës së re dhe kërkesën për formimin e industrisë private të sigurisë.

Formimi i sektorit privat të sigurisë, në të cilin funksionojnë provajderë privatë joshtetërorë të sigurisë, të pavarur nga shteti, paraqet moment të rëndësishëm për zhvillimin, si në marrëdhëniet bashkëkohore ndërkombëtare, ashtu edhe në funksionimin e vetë shteteve.

Industria private e sigurisë, kompanitë private ushtarake dhe të sigurisë, formojnë zinxhirin industrial që lirshëm funksionon në tregun global, të organizuar përmes lidhjeve korporative ekzistuese dhe të forta, e që vazhdimisht rritet dhe forcohet.

Në kuptimin më të gjerë, aktorët që i përkasin sektorit privat të sigurisë përbëhen prej një spektri të ndryshëm të njerëzve, organizatave dhe aktiviteteve. Disa prej tyre janë shumë të rëndësishme dhe legjitime ndërsa disa janë të paligjshme dhe përkasin në zonën e ashtuquajtur zona e errët e sigurisë.

Në sektorin privat të sigurisë mund t'i numërojmë mercenarët, vullnetarët, nëpunësit e huaj të etabluar në ushtritë kombëtare, lloje të ndryshme të ushtrive dhe milicive private, agjencitë private të sigurisë, kompanitë private ushtarake si dhe shumë aktorë si ofrues të shërbimeve të sigurisë dhe ushtarake.

Në këtë punim do të fokusohemi tek mercenarët, kompanitë private të sigurisë dhe kompanitë private ushtarake, me interes të veçantë tek kompanitë private ushtarake (KPU) dhe përdorimi i kompanive private ushtarake në konfliktet ndërkombëtare, dallimi mes kompanive private të sigurisë (KPS) dhe kompanive private ushtarake.

1. PËRKUFIZIMI I EMËRTIMIT “MERCENARË”

Mercenarë: Nathan mercenarët i përcakton si “ushtarë të cilët huazohen nga shtetet e huaja ose lëvizjet kryengritëse për kontribut në udhëheqjen e një konflikti të armatosur, me angazhim direkt ose indirekt në konflikt, me anë të trajnimit, logjistikës ose mbledhjes së të dhënave; këtë veprimtari ata e ushtrojnë jashtë kompetencave të forcave të armatosura ose shtetit të cilit i përkasin”.³ Fjalori i Oksfordit mercenarët i përcakton si “ushtarë profesionalë të rekrutuar të shërbejnë në

³Nathan, L. (1997), “Lethal Weapons: Why Africa needs alternatives to hired guns”, Track Two, 6 (2), August.

ushtritë e huaja”.⁴ Konventa e Gjenevës përdor gjashtë kriteriume për përcaktimin e nocionit mercenarë (shiko: Protocol Additional to the Geneva Convention of 12 August 1949, relating to the Protection of Victims of International Armed Conflicts, Geneva, ICRC, 1997: Article 47: Mercenaries. Herein after referred to as Protocol I).

Një prej përcaktimeve më të reja të nocionit mercenarë është: “Mercenarët janë individë të cilët luftojnë në konflikt të armatosur të motivuar dhe të udhëhequr nga dëshira për përfitime financiare personale në luftërat e huaja (lufta që nuk i udhëheqin shtetet në të cilët kanë nënshtetësi, nuk janë banorë të territorit – shtetit në të cilin ka konflikt të armatosur, as nuk janë pjesëtarë të forcave të rregullta të armatosura në palët në konflikt), ata kryesisht angazhohen nga grupet e armatosura, ndërsa përkohësisht edhe nga shtetet”.⁵

Angazhimi i mercenarëve është i ndaluar me të drejtën ndërkombëtare. Megjithatë problem kryesor paraqet përcaktimi – përkufizimi i nocionit mercenarë.⁶

Shtetet, me dekada përpiqen të përkufizojnë drejt këtë nocion. Megjithatë ende nuk kanë ardhur deri në përkufizimin e vetëm i cili plotësisht do të futet dhe pranohet në të drejtën ndërkombëtare. Tani për tani duket se ende nuk është e mundur të arrihet deri në përkufizimin e pranuar ligjor për mercenarët, që është i vërtetuar në tre konventat e fundit ndërkombëtare të cilat e trajtojnë këtë çështje.

Tradicionalisht mercenarët përcaktohen si individë të cilët huzohen për pjesëmarrje në luftëra të cilat nuk i udhëheqin shtetet e tyre amë.⁷

Motivimi i tyre kryesor është përfitimi dhe jo patriotizmi ose përkushtimi ndaj kombit ose shtetit të vet. Mercenari mund të jetë aventurier, ish-pjesëtar i forcave të armatosura, ndërsa shumë shpesh ata janë vrasës, të gatshëm për t’u rekrutuar nga cilado organizatë, pa marrë parasysh arsyen e angazhimit ose natyrën e veprimit përveç shumës së parave që paguajnë. Ndonjëherë ata janë veteranë të luftërave ose konflikteve të ndryshme të cilët kërkojnë të angazhohen sërish për t’i kryer

⁴The Oxford Essential Dictionary of the US Military, 2001.

⁵Schreier, Fred and Caparini, Marina (2005), „Privatising Security: Law, Practice and Governance of Private Military and Security Companies”, Occasional Paper – №6, DCAF, Geneva, March, pp 20.

⁶Schreier, Fred and Caparini, Marina (2005), „Privatising Security: Law, Practice and Governance of Private Military and Security Companies”, Occasional Paper – №6, DCAF, Geneva, March, pp 21.

⁷United Nations, General Assembly, A/RES/44/34, internet.

veprimtaritë të cilat i kanë bërë më herët, nëpër luftërat e konfliktet ku kanë marrë pjesë. Në bazë të kësaj, mund të konkludojmë se njerëzit domosdoshmërisht nuk duhet të bëhen mercenarë vetëm për shkak të përfitimeve financiare, shumë shpesh edhe për shkak të ndërjegjes. Ky është i vetmi stil dhe mënyrë e jetës që individë të këtillë mund ta kenë. Dështimi i programeve për riedukim ose programet për kthimin në të ashtuquajturën jetë civile, që do të siguronin shpresë për luftëtarët, shpesh luajnë rol të rëndësishëm te ata të cilët vazhdojnë të jetojnë dhe veprojnë si mercenarë.⁸ Për dikë që gjithë jetën e tij e ka kaluar në luftime dhe lufta, nocioni se nuk përshtatet në mjedisin e civilizuar dhe jetën normale paraqet motiv kryesor të bëhet mercenar. Shumica e mercenarëve janë ushtarë pa vend të përhershëm të jetesës, që për shumta të mëdha parash luftojnë për qëllime tejet të dyshimta.

Në përgjithësi, mercenarët nuk kanë aftësi, kapital, metoda, standarde të vendosura – të përhershme dhe mundësi të organizojnë dhe zbatojnë operacione multisektoriale, ashtu siç janë në gjendje kompanitë private ushtarake (Tabela nr. 1).

Tabela 1 – Dallimi mes mercenarëve dhe kompanive private ushtarake dhe të sigurisë	
Kompanitë private ushtarake dhe të sigurisë	Mercenarët
Kanë strukturë të përhershme organizative të karakterit korporativ, e vendosur sipas një hierarkie të caktuar dhe e drejtuar, me strukturë të qartë	Paraqesin grupe të përkohshme ad hoc të ushtarëve-luftëtarëve individual
Paraqesin kompani të regjistruara ligjore	Nuk janë legalë, ndërsa në të shumtën e rasteve janë të ndaluar me ligj
Janë të orientuara kah marketingu, gjegjësisht kanë tendencë për promovim më të madh dhe reklamimin e shërbimeve të tyre	Veprojnë në fshehtësi dhe e fshehin ekzistencën e tyre

⁸Schreier, Fred and Caparini, Marina (2005), „Privatising Security: Law, Practice and Governance of Private Military and Security Companies”, Occasional Paper – №6, DCAF, Geneva, March, pp 24.

Mënyra e financimit është e njëjtë si edhe tek subjektet tjera të përkohshme	Pagesa e shërbimeve nuk është e rregulluar, më shpesh bëhet personalisht dhe me para të gatshme
Kanë spektër të gjerë të shërbimeve që ua ofrojnë klientëve të ndryshëm. Kanë marrëveshje si me qeveritë e shteteve të ndryshme, ashtu edhe me organizatat ndërkombëtare dhe aktorët joshitetorë	Kanë numër të vogël të klientëve dhe shërbime që reduktohen në veprime luftuese. Huazohen më shpesh nga organizatat kryengritëse dhe terroriste
Struktura organizative është e tillë që mundëson kryerjen e disa punëve menjëherë, me staf të disiplinuar dhe në mënyrë shumë efektive	Angazhohen për kryerjen e një pune, efikasiteti i kryerjes është në pikëpyetje, ndërsa disiplina e papërshtatshme

2. PËRKUFIZIMI DHE KLASIFIKIMI I KOMPANIVE PRIVATE TË SIGURISË (KPS)

2.1 Kompanitë private të sigurisë

Edhe pse termi “kompani private e sigurisë” është në përdorim në shumë vende-shtete, rreth kuptimit të saktë të këtij nocioni zhvillohen diskutime të shumta. Goddard i përkufizon KPS-të si kompani të regjistruara civile që janë të specializuara për ofrimin e shërbimeve të kontraktuara të natyrës komerciale të kompanive vendore dhe të huaja, për mbrojtjen e personave, punëtorëve humanitarë ose komplekseve industriale brenda kornizave ligjore të shtetit në të cilin zhvillohet veprimi i tillë.⁹ Përkufizim më të gjerë për KPS-të japin grupe të autorëve, se KPS-ja është e strukturuar dhe e vendosur në mënyrë hierarkike, asociacion i regjistruar korporativ i cili ofron shërbime të karakterit të sigurisë, duke garuar me firma tjera të tilla për fitimin e punës në treg.¹⁰

Tregu i KPS-së ekziston gjatë kohë, është shumë i madh edhe konkurrenca në atë treg është shumë më e mprehtë në krahasim me fushën e KPU-së. Dy karakteristika kryesore i karakterizojnë KPS-të: përpjekja për fitim dhe ofrimi i shërbimeve të sigurisë së brendshme

⁹Goddard,S. (2001), The Private Military Company: A Legitimate International Entity Within Modern Conflict, A thesis presented to the Faculty of the US Army Command and General Staff College, Fort Leaven worth, Kansas, USA.

¹⁰Petrovic, Predrag, Unijat, Milosevic, Marko (2010), Komentari Nacrtzakona o privatnom obezbedjenju i Nacrt zakona o detektivskim poslovima.

dhe mbrojtjes. Numri më i madh prej këtyre kompanive janë të vogla, të fokusuara në preventimin e kriminalitetit, sigurimin e rendit dhe qetësisë publike, si edhe shërbime të sigurimit privat.

Tabela 2. – Klasifikimi i KPS-së sipas Fred Shrajer dhe Marina Kaparini, në vitin 2005

Kompanitë private të sigurisë
Firmat private të cilat ofrojnë shërbime të llojit të mbrojtjes fizike dhe sigurimin e personave dhe objekteve
Firma private që ofrojnë dhe japin shërbime konsaltingu – këshillimore
Firma private që ofrojnë mbrojtje teknike dhe video mbikëqyrje

3. PËRKUFIZIMI DHE KLASIFIKIMII KOMPANIVE PRIVATE USHTARAKE (KPU)

Në kushtet e reduktimit të veprimeve pas Luftës së Ftohtë, me zvogëlimin e aktiviteteve luftarake, shitjen e armëve dhe pajisjeve ushtarake, me privatizimin neoliberal të tregut të gjithmbarshëm, korporatat shpejt u bënë të vetëdijshme për mundësitë që qeveritë i ofrojnë me privatizimin e sektorëve të caktuar shtetëror. Shtetet, me iniciativat e tyre të reja për privatizim, duan t'i zvogëlojnë shpenzimet ushtarake dhe një pjesë të caktuar e transferojnë në sektorin privat.

Si rezultat i kësaj, fuqitë botërore, aktorët tradicionalë në konfliktet rajonale dhe ndërshtetërore gjatë Luftës së Ftohtë, e kanë zvogëluar mjaft angazhimin e tyre për zgjidhjen e konflikteve.¹¹ Kësisoj, KPU-të shpejt e shikuan mundësinë e tyre të madhe dhe e plotësuan atë vakum të sapokrijuar. KPU-të me automatizëm e angazhuan një numër të konsiderueshëm të personelit ushtarak si dhe pajisjeve ushtarake. Ato shumë shpejt filluan të ofrojnë spektër të gjerë të shërbimeve ushtarake dhe të sigurisë për klientë të ndryshëm të interesuar.

Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, vala e dytë e madhe e rritjes dhe zhvillimit të kompanive private ushtarake dhe të sigurisë filloi pas intervenimeve në Irak dhe Afganistan.

¹¹Schreier, Fred and Caparini, Marina (2005), „Privatising Security: Law, Practice and Governance of Private Military and Security Companies”, Occasional Paper – №6, DCAF, Geneva, March, pp 20.

Sipas David Isenberg,¹² KPU-të mjaft mirë i përmbushën detyrat e veta në Irak, duke kryer shumë misione të vështira në rrethana mjaft të pasigurta. Ai thotë se pjesa më e madhe e kompanive për herë të parë ishin në Irak, por ato arritën të vendosin personelin e tyre dhe t'i kryejnë detyrat për një periudhë më të shkurtër kohore nga sa ka qenë e nevojshme për ushtritë e rregullta kombëtare.

Procesi i globalizimit në ditët e sotme ndikon në qeveritë e ndryshme nëpër botë shpesh të kalojnë drejt privatizimit në pjesë të pronës shtetërore si edhe veprime të tjera të ndryshme në kompetencë shtetërore me qëllim zvogëlimin e shpenzimeve vjetore. Trendi i tillë është dukuri e dukshme në fushën e energjetikës, komunikacionit, telekomunikacioneve etj, por në disa dekadat e fundit bëhet gjithnjë më e dukshme në fushën e sigurisë. Numri i madh i shteteve, dhe sidomos i vendeve perëndimore, lënë hapësirë monopoli shtetëror ndaj përdorimit të forcës si masë të sigurisë, me qëllim që gradualisht të krijojnë hapësirë dhe të hapin derën për përfshirjen e interesave private në fushë-veprimin e sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Shpeshherë përveç KPU-ve përdoren terme të tilla si kompani të mercenarëve dhe sigurimit privat (KSP). Deri para ca kohe, mercenarë ishte termi standard për aktorët në konflikt që zakonisht ishin të motivuar vetëm nga fitimi personal. Ky term shfaqet në disa marrëveshje ndërkombëtare edhe përveç asaj këto marrëveshje ishin kritikuar për shkak të saktësisë së pamjaftueshme, sepse ata janë të fokusuar edhe në motivacionin për veprime të cilat më vështirë mund të identifikohen se sa vetë veprimet e këtilla. Për shembull, shumë prej ofruesve amerikanë të shërbimeve për sigurim në Irak pohojnë se punojnë në mënyrë të barabartë për shkak të patriotizmit dhe për shkak të përfitimit financiar. Shumë firma që janë të specializuara të mbrojnë personelin dhe pronën, në vend se të merren me aktivitete luftarake, më shumë duan të identifikohen si KPS. Por kur mbrojtja ka ndikim serioz ndaj rezultatit nga konflikti, është e vështirë të bëhet dallimi mes rolit luftues dhe mbrojtës.

Përdoruesit e shërbimeve që i ofrojnë KPU-të mund të jenë shtetet, organizatat ndërkombëtare, organizatat joqeveritare (OJQ), agjencitë humanitare dhe agjencitë për zhvillim, korporatat multinacionale madje edhe individë me nënshkrimin e marrëveshjeve përkatëse. Gjatë

¹²Isenberg, D.(2004), A Fistful of Contractors: The Case for a Pragmatic Assessment of Private Military Companies in Iraq, BASIC Research Report 2004 of the British American Security Information Council, September.

përdorimit të KPU-ve nga ana e shteteve, këto kompani shpeshherë përdoren që të kompensojnë mosekzistimin e kapacitetit kombëtar. KPU-të ofrojnë aftësi bashkëkohore teknologjike në fushat ku forcat e armatosura nuk mund të lejojnë të trajtojnë më shumë personel ose të krijojnë mundësi për karrierë atraktive. Në raste të tjera, KPU-të zëvendësojnë kapacitetin që nuk ekziston. Për shembull, huazimi i firmës Izraelite “Levdan” i mundësoi presidentit të Kongos – Brazavil Paskal Lisuba në vitin 1994 të krijojë forcë të re që t’i zëvendësojë njësitë ushtarake që i qëndronin besnik ish-presidentit dhe të shndërrojë ushtrinë në ushtri moderne të orientuar ndaj ushtrive perëndimore. Grupet e tjera i përdorin KPU-të që t’u ndihmojnë të funksionojnë në mjedise të rrezikshme dhe konfliktuale, për shembull si Iraku dhe Afganistani. Nga KPU-të kanë përfitim potencial edhe Kombet e Bashkuara (KB) dhe organizata të tjera ndërkombëtare sepse vendosja e tyre do t’i nënshtrohet kontradiktës së vogël politike se sa një vendim për vendosjen e trupave kombëtare nën patronazhin e KB-së.

3.1 Tipologjia e kompanive private ushtarake

Tipologjia e kompanive private ushtarake bazohet kryesisht në funksionet, respektivisht aktivitetet të cilat ato i kryejnë. Ato ndahen në tri kategori kryesore të aktiviteteve në bazë të së cilave mund të bëhet edhe ndarja e kompanive:

- Kompani ushtarake luftuese që sigurojnë forca të afta për luftim dhe forca për siguri. Ky lloj i kompanive në botën e KPU-ve janë më të njohura dhe deri tani kanë marrë publicitet të madh në opinion. Kompanitë ushtarake luftuese, në kuadër të grupit të tyre, mund të ndahen në kompani luftuese ofensive dhe defensive.¹³
- Kompani ushtarake konsultuese që tradicionalisht ofrojnë dhe sigurojnë trajnim dhe shërbime këshillëdhënëse.¹⁴
- Kompani ushtarake për mbështetje që sigurojnë ndihmë jovekdeprurëse, si mirëmbajtjen e armëve, mbështetje teknike, deminimin

¹³Si shembuj për KPU ofanzive mund të theksohen, “Egzekutiv Autkams”, të Afrikës Jugore dhe “Sendlajn Internacional” të Britanisë së Madhe, ndërsa shembull më i mirë për KPU-të me rol defensiv paraqet “Blackwater”.

¹⁴KPU-ja më e njohur e cila ofron shërbime konsultuese është MPRI-Military Professionals Resources In., e cila sot punon nën emrin L-3 Communications).

dhe shkatërrimin e pajisjeve joeksplozive shpërthyesë, si dhe shërbime për mbledhjen e të dhënave inteligjente dhe analizë.¹⁵

Nuk mund të përcaktohet vijë konkrete e cila i dallon kompanitë private ushtarake njëra nga tjetra në bazë të funksioneve të tyre primare, sepse një kompani e njëjtë mund të kryejë më shumë funksione dhe të ofrojë më shumë se një kapacitet në të njëjtën kohë. Si shembull, kompanitë konsultuese ushtarake ofrojnë spektër të gjerë të shërbimeve edhe kur ato nuk kanë kapacitet të duhur në dispozicion që të përmbushin marrëveshjen, pas marrjes së tyre qasen në huazimin e kompanive të tjera të ngjashme.

4. KOMPANITË PRIVATE USHTARAKE LUFTUESE

Lloji i parë i KPU-ve janë KPU-të luftuese. Këto kompani janë përfshirë në kryerjen e operacioneve ofensive ushtarake – luftarake që kanë synim të ndryshohet vendosja strategjike në konflikt ose në një luftë të caktuar, si dhe në operacione defensive luftarake për mbrojtjen e personave, pronës dhe kapaciteteve të caktuara. Për shkak të kapaciteteve të tyre luftarake, KPU-të luftuese janë edhe më të fuqishme në kuadër të industrive private ushtarake në kuptim të aftësive të tyre, gatishmërisë për përfshirje në operacionet luftarake dhe afërsinë e tyre të drejtpërdrejtë në veprime të dhunshme. KPU-të luftuese janë më të vogla kur bëhet fjalë për numrin e tyre të përgjithshëm, por me siguri mund të thuhet se janë më vdekjeprurëse. Ato ofrojnë shërbime në frontin e operacioneve luftuese, duke u përfshirë në beteja drejtpërdrejt dhe personalisht, duke kontrolluar njësitë ushtarake dhe të ngjashme. KPU-të luftuese janë në gjendje të vendosin forca ushtarake në përpjekje t'u ndihmojnë klientëve të tyre të ruajnë ose përsëri të vendosin rend politik, fuqi ushtarake ose të ndryshojnë kontrollin strategjik të luftës.

Klientët e KPU-ve luftuese janë vende të botës së tretë me kapacitete relativisht të dobëta ushtarake që ballafaqohen me situata emergjente të rrezikut të lartë, si dhe vendet e zhvilluara si SHBA-ja dhe Britania e Madhe. Në përgjithësi, KPU-të operojnë në vendet e botës së tretë. Zakonisht, qeveritë e tyre janë ato që më së shumti kanë nevojë për intervenim në konfliktet ushtarake, por njëkohësisht janë më pak të

¹⁵Shembull më i mirë për këtë kategori të KPU-së sigurisht është KBR-ja (KBR – Kellogg Brown & Root) e cila ka marrëveshje të mëdha logjistike me Ushtrinë e SHBA-së.

afta t'i lejojnë shërbimet ushtarake nga kompanitë ushtarake. Në kuadër të KPU-ve luftuese mund të ndahen kompanitë private ushtarake defensive dhe ofensive.

Shembull më i mirë për kompani private ushtarake ofensive e cila ka kryer operacione klasike ushtarake është kompania e Afrikës së Jugut “Ekzekjutiv Autkams” (EA). “Ekzekjutiv Autkams” mund të definohet si kompani private ushtarake e cila në thelb ka qenë batalion për huazim, e gatshme të kyçet në operacione luftuese në emër të klientëve të tyre, qofshin këto kompani multinacionale, aktorë joshtetërorë ose shtete, me qëllim ndryshimin e ndikimit strategjik në konflikt. Marrëveshja e tyre e parë në Afrikë ishte me kompanitë e naftës “Shevron” dhe “Sonogal” për mbrojtjen e instalimeve të tyre të naftës në Sojo, Angola. Mes viteve 1993 dhe 1994 “Ekzekjutiv Autkams” ka qenë e huazuar nga Qeveria e Angolës që të trajnojë një numër prej 4000 – 5000 trupa qeveritare ushtarake të Angolës dhe 30 pilotë. Në vitin 1994 kompania ka qenë e kontraktuar nga qeveria e Angolës të luftojë me luftuesit e UNITA nën udhëheqjen e Xhonas Savimbi, megjithatë ndihmoi të përfundojë lufta civile trevjeçare me shtypjen e UNITA-s dhe detyrimin e Savimbit të nënshkruajë marrëveshje-protokollin “Lusaka” në nëntor të vitit 1994, në Lusaka, Zimbabve. Në këtë rast kompania EA ka kryer operacione direkte luftuese. Ndikimi i kësaj kompanie ishte i tillë që personeli i saj u tregua si kryesor në ndryshimin e të gjithë kursit të luftës në Angola. Në vitin 1994 pjesëtarët e kësaj kompanie, të mbështetur nga ushtria e Angolës, i ndërmoren instalimet e naftës në Sojo dhe minierat e diamantit në zonën Kafuno të cilat i kontrollon grupi kryengritës UNITA.¹⁶ Operacionet ushtarake të EA-së kanë luajtur rol të rëndësishëm dhe të ndikueshëm edhe në transformimin e forcave të armatosura të Angolës në forcë efektive luftuese kundër UNITA-së kryengritëse. Stafit i EA-së i ka trajnuar forcat e Angolës për taktika ushtarake, këmbësorinë e motorizuar, artilerinë, inxhinierinë, lidhjet, mbështetjen mjekësore, njësitë zbuluese, ndërsa njëkohësisht, së bashku me ato kanë marrë pjesë në luftimet me UNITA-n. pjesëtarët e EA-së, gjithashtu fluturuan me avionë në hapësirën ajrore ushtarake të Angolës dhe kanë marrë pjesë në operacione speciale për shkatërrimin e vendeve komanduese të UNITA-së. Gjatë kryerjes së detyrave në Angola më shumë se 1400 njerëz ishin aktivë të angazhuar nga EA-ja.

¹⁶UNITA – The National Union for the Total Independence of Angola

I njëjtë është edhe rasti kur “Ekzekutiv Autkams” e ka pranuar marrëveshjen të ndërhyjë ushtarakisht në Siera Leone gjatë qeverisjes së Valentin Shtraser. Marrëveshja e kompanisë nuk ka përmbytur vetëm sigurimin e trajnimit ushtarak dhe logjistikës por edhe ekzekutimin e operacioneve ushtarake ofensive kundër Frontit të Bashkuar Revolucionar (RUF)¹⁷ i cili ka kontrolluar një pjesë të madhe nga eksporti i pasurive natyrore të vendit. Mes dhjetorit të vitit 1995 dhe tetorit të vitit 1996 EA-ja ka lansuar një sërë operacione të cilat e kanë siguruar kryeqytetin Fritaun duke i marrë përsëri minierat e diamantit dhe duke i shkatërruar fortesat e RUF-it. Ndikimi strategjik i EA-së e ndryshoi balancin e forcës ushtarake, duke e kthyer kontrollin përsëri në duart e qeverisë.¹⁸ Pas kthimit të minierave të diamantit nga ana e EA-së, kompanitë minerare filluan përsëri në mënyrë intensive të investojnë në operacionet e minierave, duke e lënë sigurinë në duart e EA-së. Për kthim, kompania EA ka marrë shumë të caktuar parash nga Qeveria, ndërsa një degë ka marrë koncesion në minierën e diamantit. Qeveria e Siera Leone ishte e bindur se EA-ja mund të kryejë punën për t’i dhënë fund konfliktit shumë më mirë se sa forcat e veta ushtarake ose organizatat internacionale, si për shembull Organizata e Kombeve të Bashkuara. Marrëveshja mes EA-së dhe Qeverisë së Siera Leone ka qenë e ndërprerë në janar të vitit 1997. Një prej parakushteve për paqe nga ana e RUF-it ishte që EA-ja të lëshojë vendin. Ndërprerja e marrëveshjes me EA-në më vonë është treguar si gabim fatal i presidentit të atëhershëm Kabah sepse ende ka ekzistuar jostabilitet në vend, luftëra në vende të caktuara dhe mundësi për grusht ushtarak para ardhjes së paqeruajtësve të OKB-së.

EA-ja paraqet pionier në mesin e KPU-ve që kanë kryer operacione klasike ushtarake. Gjatë involvimit të saj në operacionet ushtarake në Afrikën Sub-Sahariane në vitet e “90-ta të shekullit të kaluar”,¹⁹ ajo u bë lider i tregut në kuadër të industrisë private ushtarake, pastaj duke hapur rrugën për zhvillimin e KPU-ve tjera, të cilat, përveç operacioneve luftuese mund të ofrojnë edhe shërbime të tjera ushtarake të specializuara.

¹⁷RUF (Revolutionary United Front)

¹⁸Për 10 muaj EA-ja arriti të sigurojë paqe në Siera Leone ku dhuna ekstreme u tregua imune ndaj përpjekjeve paraprake të OKB-së dhe Organizatës së Unitetit Afrikan.

¹⁹Përveç Angolës dhe Siera Leone, ka qenë aktive edhe në vende të tjera si Kenia dhe Uganda.

Shërbimet e këtyre kompanive i përdorin shtetet, OJQ-të, OKB-ja, organizatat humanitare, organizatat si NATO-ja dhe vendet e botës së tretë të prekur nga konfliktet, por edhe kompanitë energjetike dhe të minierave, kompanitë televizive për gazetarët e tyre etj. Qoftë kur bëhet fjalë për luftë, konflikt ose rikonstruim të pastluftës, involvimi i kompanive është i rëndësishëm së jashtëzakonshme për subjektet e theksuara.²⁰ Përveçse drejtpërsëdrejti marrin mbrojtje cilësore, angazhimi i KPU-së paraqet mënyrë efikase për menaxhimin e rreziqeve politike.

Një prej kompanive më të njohura private ushtarake e cila numërohet në këtë kategori, por njëkohësisht edhe më kontroverze dhe ekstreme, është “Blackwater” e cila rritjen dhe famën më të madhe e ka pasur gjatë luftës në Irak në vitin 2003. E themeluar në vitin 1997 nga Erik Princ, ish-pjesëtar i “SEAL” – forcat speciale të SHBA-së²¹, “Blackwater” siguron shërbime ushtarake të sigurisë për nevojat e shtetit dhe për kompani të ndryshme në mbarë botën, si sigurim personal për misionet ushtarake dhe diplomatike. Sa është kuptimi dhe rëndësia që u është dhënë dhe ende u jepet këtyre kompanive, flet e dhëna se marrëveshjen e parë për sigurim “Blackwater” e ka bërë me CIA-n në Prill të vitit 2002 për mbrojtjen e bazës së CIA-s në Kabul, Afganistan. Në fillim të vitit 2003 kompania “Blackwater” ka qenë e gatshme të marrë dhe të përpunojë edhe marrëveshje të tjera me fillimin e luftës në Irak.

Misioni primar i kompanisë gjatë luftës në Irak të vitit 2003 ishte zbatimi i sigurimit ushtarak. Duke pasur parasysh disa prej marrëveshjeve të para në luftën Irakiane, “Blackwater” e ka marrë detyrën për sigurimin e autoritetit të koalicionit të përkohshëm (AKP) i cili ka qeverisur në Irak menjëherë pas rënies së regjimit të Sadam Huseinit.²² Më 28 gusht të vitit 2003 “Blackwater”, pa asnjë tender e fitoi marrëveshjen ekskluzive të sigurojë mbrojtje të KPU-së. Për nevojat e kësaj marrëveshjeje “Blackwater” siguroi 36 ish-pjesëtarë të forcave speciale, ekipe speciale me qenë dhe tre helikopterë. Pjesa më e madhe e marrëveshjeve të “Blackwater” erdhën nga marrëveshja për shërbime të mbrojtjes personale nga Stejt Departamenti, nga i cili deri në fund të

²⁰Jordi Palou-Loverdos, Leticia Armendáriz, *The Privatization of Warfare, Violence and Private Military & Security Companies*, 2011,

²¹Navy SEAL (Sea, Air Land Teams), njësi speciale detare për veprim në det, në ajër dhe tokë.

²²Qeveria tranzituese në Irak e formuar pas deklaratës së 19 marsit të vitit 2003.

vitit 2004 kompanitë private ushtarake fituan marrëveshje federale në vlerë prej mbi një miliardë dollarë.

Tashmë paraprakisht është përmendur se “Blackwater” është një prej organizatave më të diskutueshme, nëse jo edhe kompania private ushtarake më e diskutueshme që ka qenë e involvuar në operacionet në Irak. Edhe pse defensive sipas karakterit, kompania “Blackwater” ka qenë e kyçur në shumë incidente që kanë përfshirë të shtëna direkte me rebelë. Kështu, një prej incidenteve më të mëdha, që shënuan përfshirjen e kompanisë private ushtarake në luftë, ishte prita e pjesëtarëve të “Blackwater” në Falluxha në mars të vitit 2004 nga ana e rebelëve sunitë. Pastaj katër anëtarë të sigurimit të konvoit me ushqim dhe pajisje ishin sulmuar në pritën e koordinuar. Vargani ishte sulmuar me granatohedhës dore, ndërsa pastaj edhe me armë këmbësorie, pasi që vijuan të shtëna të vazhdueshme. Tjetër rast paraqesin të shtënat në Naxhaf në gusht të vitit 2004, kur pjesëtarët e “Blackwater”, paqeruajtësi salvadorian dhe marinsat amerikanë, u përfshinë në luftën katërorëshe kundër kryengritësve shiitë për mbrojtjen e instalimit të ushtrisë amerikane. Gjatë kohës së zhvillimit të kësaj lufte, në ndihmë janë thirrur forca ushtarake shtesë, por në të njëjtën kohë pjesëtarët e “Blackwater” arritën t’i përgjigjen sulmit, ndërsa me helikopterë të bëjnë nxjerrjen e të plagosurve dhe të sjellin municion shtesë. Me involvimet e tilla në luftë, edhe pse në rolin defanziv, aksionet e “Blackwater” e rritën kredibilitetin e kompanisë dhe perceptimin se ajo mund t’i plotësojë në tërësi marrëveshjet pa dallim të mjedisit dhe rrezikun në të cilin kryhen operacionet

5. KOMPANITË PRIVATE USHTARAKE KONSULTUESE

Lloji i dytë i KPU-ve janë kompanitë ushtarake konsultuese. Këto kompani ofrojnë shërbime për mbështetje të operacioneve ushtarake, si dhënien e këshillave për përgjigjet taktike ofensive, shërbime këshillëdhënëse ushtarake që mbulojnë fusha nga ristrukturimi i forcave të armatosura, këshilla për furnizim me pajisje ushtarake, madje edhe këshillim në lidhje me taktikat ushtarake dhe ndoshta më të rëndësishmen, ofrimin e trajnimit ushtarak për fitimin e aftësive ushtarake si menaxhimi me armë dhe sistemi me armë, manovrat luftarake, trajnim për armët me teknologji të lartë, trajnim të inteligjencës etj. Këto shërbime ofrohen për forcat e armatosura të një numri të madh të vendeve të pazhvilluara, vendeve në zhvillim, por i përdorin edhe vendet e

zhvilluara si SHBA-ja dhe Britania e Madhe. KPU-të që sigurojnë shërbime konsultuese në të kaluarën ishin të huazuara të asistojnë në vendet e botës së tretë të prekur nga konflikti si Liberia, Mozambiku, Nigeria, Sudani, ose ishin të huazuar nga vendet e zhvilluara të ndërvehojnë në vendet e botës së tretë me qëllim t'i trajnojnë forcat e tyre të armatosura gjatë konfliktit, si për shembull MPRI gjatë konflikteve të Ballkanit dhe në Irak. Pavarësisht kësaj, këto kompani kanë pasur rol të rëndësishëm edhe në ristrukturimin e forcave të armatosura të shteteve të caktuara.

Në kuadër të këtyre KPU-ve shërbimi më i madh që ofrohet është trajnimi ushtarak. Trajnimi dhe shërbimet këshillëdhënëse janë të lidhur direkt për operacionet luftuese, por megjithatë kanë ndikim edhe ndikimi strategjik ofensiv në konflikt të caktuar ose strukturë ushtarake të forcave mbrojtëse të klientëve. Kjo është për shkak se këto shërbime ushtarake e forcojnë aftësinë e forcave të caktuara të armatosura në mënyrë aktive të luftojnë dhe direkt të kyçen në luftë. Kështu, disa KPU mes shërbimeve të tjera, ofrojnë edhe trajnim për operacionet kundër-terroriste dhe trajnim ushtarak që përfshin trajnimin e forcave speciale. Detyra e KPU-së të kësaj kategorie është të forcojë menaxhimin dhe trajnimin e forcave të armatosura të klientit të tyre, por mos të përfshihet në luftë. Ato kanë kapacitet të luajnë rol kryesor në përgatitjet për operacionet e armatosura ose madje edhe gjatë komandimit gjatë operacioneve të armatosura, duke dhënë këshilla për përdorimin e armëve dhe njësive.

Në vitin 1994 gjatë konfliktit Ballkanik, MPRI-ja ishte e huazuar nga forcat e armatosura kroate që të projektojnë program për trajnim për përmirësimin e efikasitetit, cilësisë dhe kapaciteteve të ushtrisë kroate. Kjo rezultoi me lansim të ofensivës jashtëzakonisht të suksesshme të ushtrisë kroate në vitin 1995 kundër forcave serbe në Krainë, gjegjësisht operacioni "Bura". Në këtë operacion është përdorur taktika tipike amerikane, si lëvizje të integruara ajrore, artilerike dhe këmbësorike dhe përdorim të manovrimeve luftuese për shkatërrimin e rrjeteve serbe të komandimit dhe kontrollit. Trajnimi ushtarak dhe ekspertiza e MPRI-së pa dyshim ka çuar deri në sukseset e mëdha të ushtrisë kroate dhe në mënyrë të pamëshirshme e tregon lidhjen indirekte me operacionet luftuese. Më tej, në konfliktin Ballkanik, MPRI e ka fituar marrëveshjen me boshnjakët për trajnimin dhe pajisjen e forcave të tyre të armatosura. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje ka qenë MPRI-ja të integrojë dhe të ndërtojë ushtri boshnjake nga muslimanët dhe kroatët, kundër

serbëve boshnjakë. Në këto përpjekje MPRI filloi me Shkollën për Doktrinën Ushtarake dhe simulimet luftuese dhe ndërtoi vendqitje të madhe afër Livno në Hercegovinën Perendimore, e cila ka qenë nën kontrollin e kroatëve të Bosnjës.

Në vitet e 90-ta të shekullit të kaluar kompania MPRI ishte aktive edhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut e cila pas disa muajve angazhim në trajnimet ushtarake të pjesëtareve të ARM-së u dëbua nga shteti nga udhëheqja politika proruse, gjithashtu ishte aktive edhe në Kolumbi, si pjesë e “Planit Kolumbia”, strategji e inicuar dhe e financuar nga SHBA-ja për eliminimin e tregtisë me kokainë. MPRI-ja duhej ta riprojektojë dhe të ndihmojë në reformimin e ushtrisë kolumbiane për ballafaqimin me operacionet e luftës kundër drogës, pastaj ushtrinë ta trajnojë për luftë kundër-guerile. Fushat në të cilat është punuar më shumë janë planifikimi, operacionet ushtarake, logjistika, inteligjenca, trajnimi dhe menaxhmenti me stafin.

6. KOMPANITË PRIVATE USHTARAKE PËR MBËSHTETJE

Të fundit nga spektri i KPU-ve imponohen kompanitë private ushtarake për mbështetje të cilat ofrojnë shërbime që janë jovekjetprurëse sipas natyrës së vet. Tek ne ekziston mendimi se pikërisht këto kompani i përfaqësojnë kompanitë private ushtarake, edhe pse këto janë vetëm një pjesë prej tyre.

Këto KPU, të involvuara në ofrimin e shërbimeve për mbështetje luftarake, nuk duhet në mënyrë të pashmangshme në përbërjen e tyre të kenë staf që rrjedh nga radhët e ushtrisë dhe kryesisht nuk janë të involvuar në luftime. Si të këtilla, ato më shpesh angazhohen të sigurojnë ndonjë përparësi ushtarake të klientit që i angazhon (sidomos ushtritë) si mbështetje dhe lehtësimin e njësisë logjistike të tyre në operacionet luftarake. Pikërisht kompani të këtillë paraqet kompania “Kelog Braun dhe Root” (KBR).

Edhe pse kompanitë sigurojnë shërbime që nuk janë vdekjetprurëse sipas natyrës së tyre, megjithatë ato kanë ndikim në kuadër të natyrës strategjike të konfliktit. Ato nuk sigurojnë potencial direkt për zbatimin e operacioneve luftuese, por ofrimi i shërbimeve të tyre ushtarake megjithatë e forcon potencialin ushtarak dhe kapacitetet e klientit. Shërbimet ushtarake të cilat në fakt ofrohen, më shumë janë drejtuar të luajnë rolin e mbështetjes së ushtrive qoftë për vendet e zhvilluara ose për vendet e botës së tretë.

Shumica prej klientëve që i përdorin shërbimet e këtyre KPU-ve janë vendet e botës së tretë dhe të parë të përfshirë në intervenimet ushtarake afatgjata ose afatshkurta si SHBA-ja në Irak dhe Afganistan ose shtetet që thjeshtë duan të privatizojnë pjesën joluftuese prej kapaciteteve të tyre ushtarake. Edhe pse këto KPU nuk marrin pjesë në planifikimin ose kryerjen e operacioneve direkte ushtarake, ato sigurojnë shërbime që bëjnë pjesë në kuadër të sferës ushtarake dhe janë kritike për operacionet ushtarake. Gama e gjerë e shërbimeve për mbështetje si edhe shërbimet logjistike i numërojnë këto KPU si aktorë thelbësor gjatë vendosjes dhe mirëmbajtjes së shumicës së forcave perëndimore në rajonet e konfliktit në Irak, Afganistan, Kolumbi, kontinentin afrikan etj. Ky klasifikim, gjithashtu, përfshinë KPU-të që i mbajnë armët e teknologjisë së lartë dhe pajisjet ushtarake. Më tutje, këtu janë të përfshirë edhe KPU-të që merren me deminimin, përkatësisht shkatërrimin e pajisjeve shpërthyes si për shembull BATEC ose RONCO.

Pjesa më e madhe e këtij lloji të KPU-ve mund të thuhet se janë aspekt i fundit i operacioneve ushtarake. Shërbimet e tyre mbulojnë logjistikën, transportin, trajtimin mjekësor, punët sanitare, furnizimin me ujë dhe rrymë, furnizimin dhe përgatitjen e ushqimit, operacionet humanitare, mbrojtjen e refugjatëve ose çështjet administrative. KPU-të e specializuara për këto funksione mbulojnë spektër të gjerë të operacioneve, duke filluar nga rikonstruimi pas konfliktit deri në transportin e materialeve të rënda, transportin ajror, prodhimin e armëve, IT softwer dhe hardwer, operacionet për pastrimin e minave dhe shkatërrimin e pajisjeve eksplozive, shërbime mjekësore, komunikimet, mirëmbajtjen etj. KPU-të kanë siguruar shërbime të tilla ushtarake në shumicën e vendeve të botës së tretë, si Liberia, Sudani Jugor (Darfur), Mozambia, Etiopia, Eriteria, sepse kanë bashkëpunuar së bashku me kompanitë luftuese, si për shembull “Arkitektët dhe inxhinierët e Paqësorit” (PAE) e cila e ka transportuar personelin e “Ekzjekutiv Autkams” në Angola dhe në Siera Leone. Më tutje, “Djankorp” dhe PAE kanë siguruar mbështetje logjistike për forcat e OKB-së në Siera Leone, ekspertizën e “Ereksen” që e ka çuar këtë kompani në Irak, të kryejë mbikëqyrje ajrore të tubacioneve dhe infrastrukturës në zonat e naftës gjatë natës, ndërsa, “Korporata Titan” profitin më të madh e ka realizuar me sigurimin e përkthyesve për nevojat e ushtrisë amerikane. Kompani e këtillë e cila është e specializuar për shërbimet logjistike është edhe “Grupi Air” e cila është e vendosur në Darfur, Sudan. Ajo është e specializuar për shërbimet logjistike ajrore dhe ka siguruar mbështetje

të stafit të Unionit Afrikan. “Grupi Air” operon me flotë të avionëve në rajonin e Darfurit, me çka e ruan rrjedhën e stafit, pjesëve rezervë dhe materialet konsumuese me aftësi të vijë deri në vende të cilat zakonisht vështirë arrihet. Deri në vitin 2009 kompania ka regjistruar 10.000 orë fluturim duke transportuar 23.000 udhëtarë duke përfshirë edhe personelin e OKB-së, 14.000 ton ngarkesë dhe miliona galonë karburant avioni për forcat paqeruajtëse të Unionit Afrikan. Në vitin 2009 ka siguruar edhe helikopter për “SUPRIM”, një kompani për ushqim me të cilën direkt furnizohet misioni për distribuimin e ushqimit për forcat e ISAF-it në Afganistan.²³

KPU-të për mbështetje luajnë rol kryesor në botën e tretë ku bashkësia ndërkombëtare si OKB-ja ose vende të botës së parë si SHBA-ja tregojnë mbështetje konstante për shërbimet e tyre ushtarake logjistike. Kështu, administrata e Xhorxh Bushit të Ri krijoi kornizë, që në njëfarë mënyre i ndërliði KPU-të dhe forcat ushtarake të SHBA-së, e njohur si Programi Logjistik për rritjen civile.²⁴

Sigurisht shembull më i mirë për kompanitë për mbështetje është, “Kelog, Braun dhe Rut” (KBR) e cila është divizion i “Helibarton” dhe kompanisë e cila në fillim është marrë me projekte të mëdha civile ndërtimore, por në inxhinierinë ushtarake ka gjetur biznes mjaft fitimprurës, në kuadër të këtyre kompanive funksionon edhe kompania EKOLOG nga Republika e Maqedonisë së Veriut me seli në Tetovë.

7. ARSYETIMI PËR PËRDORIMIN E KOMPANIVE PRIVATE USHTARAKE

Një nga argumentet kryesore për mbështetje të involvimit të madh të KPU-ve në operacionet bashkëkohore ushtarake në kohët e fundit sigurisht se janë paratë që ato ua kursejnë shteteve që i huazojnë. Kursimi i parave është subjekt i debatit, por edhe përveç kësaj qeveritë pohojnë se shumtë që kursehen me përdorimin e shërbimeve nga kompanitë private shprehen në miliona. Si kursime më të mëdha për shtetet dhe qeveritë e tyre përfaqësojnë shërbimet ushtarake të specializuara. Si shembull mund të përmenden SHBA-të që janë mjaft të varur në këtë pjesë nga kompanitë private pikërisht si rezultat i risive teknologjike nga strukturat civile. Konkretisht, progresi në teknologjinë informatike

²³ИСАФ – ISAF (International Security Assistance Force)

²⁴LOGCAP – Logistics Civil Augmentation Program.

konsiston me nevojën që ushtria të duhet të kërkojë ndihmë nga jashtë. Një prej arsyeve pse të punësuarit në kompanitë private kanë kontroll në llojin e tillë të pajisjeve është se pjesa më e madhe e personelit ushtarak nuk disponon me përvojë të mjaftueshme dhe përvojë që t'i zhvillojë aftësitë e kërkuara me qëllim që ta ruajë dhe të manipulojë me këtë pajisje. Shpeshherë disa shërbime speciale huazohen sepse nuk është e logjikshme ushtria të intervenojë në ndonjë zonë e cila relativisht është e vogël, mund të realizohet për periudhë të shkurtër kohore dhe për më tepër edhe do të duhet të trajnojë personel enkas për këtë.

Arsyet politike, siç është theksuar më parë, para se gjithash reflektohen në përdorimin e fshehtë të KPU-ve në zona dhe fusha të caktuara të ndjeshme. Shpesh arsye e neglizhuar për involvimin e kompanive private ushtarake është se strategjia e përdorimit të tyre të fshehtë u mundëson SHBA-ve të sigurojnë ndihmë jozyrtare të grupeve të caktuara në kushte ku vetë SHBA-të mund të përballen me kontradikta ose shkelje të standardeve të neutralitetit etj. Si do që të jetë, këto motive politike shpesh kritikohen sepse e minojnë transparencën e përdorimit të KPU-ve dhe përveç kësaj lënë mundësi për keqpërdorime të ndryshme.

Mund të thuhet se të dhënat për arsyeshmërinë ekonomike të KPU-ve janë të ndryshme. Të punësuarit në KPU janë mjaft të shtrenjtë, pagat mesatare variojnë prej 400 – 1000 dollarë amerikane në ditë. Pohimet se KPU-të janë më ekonomikisht të arsyeshme sesa të mbahen ushtri të përhershme zakonisht bazohen në argumente si më poshtë:

- KPU-ja mund të punësojë personel që shpeshherë paguhet në mënyrë të konsiderueshme më pak.

- Qeveritë ose organizatat që i huazojnë, nuk duhet patjetër t'u sigurojnë KPU-ve beneficione të "fshehura" të tilla si pensionet, mbrojtjen shëndetësore, vendbanim etj., sepse kjo pjesë është zakonisht e përfshirë në marrëveshje.

- KPU-të kanë aftësi ta rrisin menjëherë numrin e forcave, pa harxhime për shkak të mirëmbajtjes afatgjate të kapaciteteve ushtarake ose "pagesën e kompensimit", kur shpeshherë ndodh që ushtria i nënshtrohet detyrimit të zvogëlimit të shpejtë. Me këtë dhe vetë ushtritë mund të përqendrohen dhe të përgatiten për mision të caktuar për periudhë shumë të shkurtër kohore.

- Me kryerjen e operacioneve kryesore joluftuese, KPU-të u mundësojnë forcave të armatosura të përqendrohen në misione thelbësore. Si shembull mund të përmendet sigurimi i personave të lartë zyrtarë,

pasi që në vend të përdorimit të personelit të njëjësive speciale përdoret personeli i kompanive private ushtarake, ndërsa njësitë speciale përdoren “atje ku me të vërtetë janë të nevojshme”.

CONCLUSION

At the time when the security threats do affect the situation and the popularization of the private security sector, as well as the decrease of the state capacities to face the same threats, it is highly possible that the trend of using Private Military Companies will continue to grow and form the international security even in the future.

Private Military Companies will continue to exist and develop even now in the contemporary world. Having in mind the regional conflicts and wars after the Cold War, disability or the lack of the desire of the international community to engage in these conflicts, as well as the effort of the great powers to decrease military forces and to rely on the sophisticated technological weapons, it is logical that the Private Military Companies will be even more developed and regulate the character of wars now and in the future.

Private Military Companies have the considerable ability to change and affect in the strategic military situations in a given conflict, be this function of combat or non-combat, in the same way or similar deciding how they will do that and regulate the military units. As it is the case with some conflicts recently, engagement of the Private Military Companies in the combat or non-combat roles can change the end result of the given conflict and create the right condition in the favor on a certain party. The growth of the PMC and the growth of popularity in their operative engagement, emphasizes the case that the clients of those global games, and especially the states, will be very dependent on the military services of those companies. All this confirms the importance that Private Military Companies have had and will have in the future.

It is supposed that after the end of the engagement of the PMC in the conflict in Iraq and Afghanistan and the withdrawal of them from those zones, their existence will not cease to exist. As a future market for those companies certainly will be imposed to the Middle East, Latin America, as well as the African countries exactly because the need for security there is grown. The new capacities that the PMC have withdrawn the new clients, not only on the Western Countries and especially US, but also beyond, as those: weak states with tyrant regimes that need

help for their armed forces. Also, the UN missions that seek more peacekeeping forces, multinational corporations that need help to protect their property and their equipment, humanitarian personnel that need protection, opposition groups that fight against the change of the regime etc.

Parallel with the development of the Private Military Companies, a real challenge in the future will be their effective and right regulation of their services, especially in the field of their responsibility for human rights violations while operating. But, no matter what will happen, they will continue to offer security in real meaning of the word through innovations and opportunities to be effective with little equipment in difficult economic times. No matter of the moral connotations positive or negative given to the private security companies, it can be said that these actors, in a global scale, have managed to change to a certain degree to shape the history of the contemporary combat. Regardless of the different predictions, private military industry has a bright future. The billion-dollar industry will not simply cease even after the end of the conflicts in Iraq and Afghanistan. On the contrary, it can happen the opposite; the Private Military Companies may fill the gap created after the withdrawal of the regular military units; with their sophisticated human high qualified and equipped force and weapons of a wide range of services, today's Private Military Companies are ready to take responsibility for combat and service support, command and control, intelligence and analysis, human support, post conflict operations etc.

Then, they are ready to face the new challenges, like counter terrorist operations and negotiations in case of hostages. Direct engagement of the PMC in the combat operations in the conflict zones will be the least possible. However, even this is possible like in previous example mentions in Angola. It seems that there is not a secure zone where PMC will not be useful. In other words, PMC will be able to operate not only in tactical level, but also fully support the modern combat through development of the new skills to face the new challenges. This industry certainly will be developed, will be more competitive and will be developed in the free market of the force where the combat tools will be in the disposition of everyone.

Recensentë:
Prof. dr. Muhamed Racaj
Prof. dr. Qebir Avziu

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

1. Peter W. Singer, *Corporate warriors: The rise of the privatized military industry*, Cornell University Press 2008,
2. Deborah D. Avant, *The market for force: The consequences of privatizing security*, Cambridge University Press, July 2005,
3. Thomas Jager, Gerhard Kummel, *Private military and security companies: Chances problems, pitfalls and prospects*, Springer science and business media, April 2009,
4. Yusuf Alabarda, Rafal Lisoëiec, *The Private Military Firms – Historical Evolution and Industry Analysis*, June 2007,
5. Molly Dunigan, *Victory for Hire: Private Security Companies' Impact on Military Effectiveness*. Stanford, CA: Stanford University Press, 2011,
6. James Cockayne, Emily Speers Mears, *Private Military and Security Companies: A Framework for Regulation*, International peace institute, March 2009,
7. Deborah D. Avant, *The rise of Private Security Companies*, Foreign Policy, June 2005,
8. Yusuf Alabarda, Lisowiec Rafal, *The Private Military Firms – Historical Evolution and Industry Analysis*, Naval postgraduate school, Monterey, California, 2007
9. Закон за приватно обезбедување, изгласан од Собранието на РМ на 24.12.2012 година Службен весник на РМ, бр. 166 од 26.12.2012 година,
10. Dan Briody, *The Halliburton Agenda: The politics of oil and money*, John Wiley & sons, 2004,
11. Rosen, Fred. *Contract Warriors: How mercenaries changed history and the war on terrorism*. New York: Alpha books, 2005,
12. Scahill, Jeremy, *Blackwater: The rise of the world's most powerful mercenary army*, New York: Nation books, 2007,
13. *The Montreux Document on private military and security companies*,
14. Nikolaos Tzifakis, *Contracting out private military and security companies*, Center for European Studies 2012,
15. Niccolo Machiavelli, *Il Principe*,
16. Caroline Holmqvist, *Private Security Companies The Case for Regulation –SIPRI Policy Paper No.9*,

17. Ltg. Ita retired Fabio Mini, An analysis of Private military and security company, European university institute, Florence academy of European laë, 2010,
18. Jordi Palou-Loverdos, Leticia Armendáriz, The Privatization of Warfare, Violence and Private Military & Security Companies, 2011,
19. Private military companies – Geneva centre for democratic control of Armed forces,
20. Anne-Marie Buzatu & Benjamin S. Buckland, Private Military & Security Companies: Future Challenges in Security Governance, DCAF horizon 2015 working paper no. 3,
21. Winston P. Nagan, The Rise of Outsourcing in Modern Warfare: Sovereign Power, Private Military Actors, and the Constitutive Process, University of Florida Levin College of Law 2008,
22. Alyson JK Bailes, Caroline Holmqvist, The Increasing Role of Private Military and Security Companies, European Parliament, Directorate-general for external policies of the union directorate b, policy department, October 2007,
23. Mark Andrew Fulloon, The Post-Fordist Military: An Inquiry into the Political Economy of Private Military Companies, March 2011,
24. Christofer Kinsley, Private contractors and reconstruction of Iraq – Transforming military logistics, Routledge Contemporary security studies, 2009,
25. Ase Gilje Ostensen, UN Use of Private Military and Security Companies: Practices and Policies,
26. Željko Branović, Privatisation of Security in Failing States: A Quantitative Assessment,
27. Louise Richards, Corporate Mercenaries: The threat of private military and security companies, Development house, 2006,
28. <http://www.eda.admin.ch/psc>
29. www.dcaf.ch/_docs/op06_privatising-security.pdf
30. www.dcaf.ch/publications/backgrounders
31. www.icasualties.org
32. www.globalresearch.ca
33. www.washingtonpost.com
34. Nathan, L. (1997), „Lethal Weapons: Why Africa needs alternatives to hired guns”,
35. The Oxford Essential Dictionary of the US Military, 2001,

36. Schreier, Fred and Caparini, Marina (2005), „Privatising Security: Law, Practice and Governance of Private Military and Security Companies”,

37. Goddard, S. (2001), *The Private Military Company: A Legitimate International Entity Within Modern Conflict*, A thesis presented to the Faculty of the US Army Command and General Staff College, Fort Leavenworth, Kansas, USA,

38. Petrovic, Predrag, Unijat, Milosevic, Marko (2010), *Komentari Nacrtzakona o privatnom obezbedjenju I Nacrtzakona o detektivskim poslovima*,

39. Isenberg, D. (2004), *A Fistful of Contractors: The Case for a Pragmatic Assessment of Private Military Companies in Iraq*, BASIC Research Report 2004 of the British American Security Information Council, September,

40. United Nations General Assembly, A/RES/44